

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 08.05.2025

Nr. 4009

Lënda: Kërkesë për informacion

Drejtuar: **DHL International (Albania) sh.p.k.**
Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga dytësore, Km 8, Kashar, Tiranë

I nderuar z. Koçollari,

Në vijim të procesit të votimit nga jashtë vendit, në vlerësim të shqetësimeve të subjektit zgjedhor Partia Demokratike – Aleanca për Shqipërinë Madhështore në lidhje me procesin e shpërndarjes së dokumentacionit zgjedhor me Greqi jeni të lutur të na dergoni URGJENTISHT, një raport në lidhje me këtë proces, referuar çështjeve si më poshtë:

1. Cilat janë strukturat dhe/ose personeli i angazhuar në këtë proces?
2. A i është deleguar ky proces subjekteve të treta? Nëse po, cila është marreveshja?
3. Sa është numri i zgjedhesve të cilëve nuk ju është dërguar njoftim për dërgesën postare të KQZ?
4. Cilat janë arsyet që kjo nuk është bërë?
5. Sa është numri i zgjedhesve që nuk ju është dorëzuar fare dokumentacioni zgjedhor?
6. Sa është numri i zgjedhesve të cilëve nuk ju është dorëzuar personalisht në dorë dokumentacioni zgjedhor?
7. A e dispononi ju dokumentacionin provues të rasteve të dorezimit të dokumentacionit zgjedhor personalisht zgjedhësit?
8. Sa është numri i zgjedhesve të cilëve dokumentacioni zgjedhor ju është tërhequr në banesë, pasi kjo ju është kërkuar nga zgjedhësi? A dispononi ju dokumentacionin provues për këto raste.
9. Sa është numri i zgjedhesve që e kanë dorëzuar/kthyer dokumentacionin zgjedhor në zyra apo qendra të tjera pritëse të operatorit të shërbimit postar? Cili është domumentacioni provues për këtë rast?

Për shkak të rëndësisë dhe urgjencës së këtij procesi, kërkojmë që informacioni i mësipërm të na vihet në dispozicion brenda një afati sa më të shkurtër.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

